Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 100 datë 29.08.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit social vendor 2026-2028 të Bashkisë Sarandë".

Analiza ligjore:

Mbështetur ne ligjn 139/" Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 "Për Shërbimet e kujdesit Shoqëror", Ligjin nr. 47/2018" Për masat ndaj dhunës në marredhëniet familjare" Ligjin 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", Ligjin 15/2019 "Per nxitjen e punësimit", Ligjin 57/2019 "Për asistencë sociale ne RSH", Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji nr. 1021, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskrimnimi", Ligjin nr. 9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH" i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqiperisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor në teresi, Bashkia Sarandë ka hartuar planin e ri social 2026-2028", perfshi Rregulloren e Funksionimit te Keshillit bashkiak Sarande.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Plani i Shërbimeve Sociale 2026-2028 të Bashkisë Sarandë synon të adresojë nevojat dhe të drejtën e grupeve vulnerabël për shërbime sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, si dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe llojshmërisë së shërbimeve.Ngritja e shërbimeve të reja është detyrë e pushtetit vendor dhe për ta mbështetur në këtë process shumë të rëndësishëm është krijuar dhe funksionon mekanizmi i Fondit social i cili financon sherbimet e reja në masë 90% për vitin e parë të shërbimit, 60% në vitin e dytë të tij dhe 30% në vitet në vazhdim.

- **Së pari** ne planin social janë analizuar strukturat ekzistuese te sherbimeve sociale në bashki dhe nevojat reale për punonjës dhe struktura në përputhje me kërkesat ligjore , reformën administrative dhe gjendjen social-ekonomike të shtresave të ndyshme shoqërore, në kushtet kur kemi një lëvizje të pakontrolluar demografike, emigracion, fenomene te tilla si dhunë në familje, rrezik trafikimi, grupe shoqërore përdorues të substancave të dëmshme, kujdestari alternative për fëmijët etj.
- Së dyti Plani social analizon shërbimet prezente në territor dhe parashikon përmirësime për këto shërbime dhe gjithashtu parashikon të ngrihen shërbime të reja , shërbim e të lëvisshme etj
- Së treti Plani parashikon edhe Buxhete të përafërta për shërbimet ekzistuese dhe për shërbimet e reja.
- Së katërti Plani i hap rrugën aplikimeve për fonde nga Fondi Social i buxhetit të shtetit. Aplikimet për projekte të ndryshme nga ky fond kryhen vetëm në kushtet kur Plani Social është i hartuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Aktualisht është planifikuar ngritja e një shërbimi të lëvizshëm për personat PAK që do të ofrojë terapi okupacionale, fizioterapi, logopedi. Aplikimi duket të dërgohet

përpara datës 5.09.2025, kështu që është thelbësor aprovimi I këtij plani me qëllim që të aplikojmë brenda afatit për këtë shërbim të ri të nevojshëm.

- Së pesti Plani social merr parasysh dhe planifikon permirësimin e shërbimeve në territor edhe në përputhje me Strategjitë Kombëtare të miratuara si ajo e Deinstitucionalizimit, integrimi i Komunitetit rom etj .

Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Sarandë bazohet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në partneritetin midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore.

Këto shërbime përfshijnë ofrimin e shërbimeve parashoqërore, sherbime në qëndrat komunitare dhe ato të zhvillimit, në qëndrat rezidenciale dhe strehëzat, sherbimet e kujdesit alternativ për fëmijët, shërbime të specializuara, shërbime të këshillimit në qendrat multifunksionale etj., ndaj fëmijëve në nevojë, viktimave të dhunës, abuzimit, trafikimit, grave, dhe të moshuarve.

Legjislacioni përcakton detyrimet specifike për shërbimin e kujdesit shoqëror në nivel vendor, që përfshijnë edhe ngritjen e Njësive të Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave, (NJRVN), të Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF), të Dhunës në Familje (NJDHF) me përgjegjësitë, dhe kerkesat profesionale përkatëse, të cilat janë pasqyruar në planin social.

Sigurisht në hartimin e Planit janë mbajtur parasysh edhe mundësitë financiare dhe burimet e të ardhurave që mund të ofrojë njësia vendore, për ta bërë planin të realizueshëm dhe efikas.

Për këtë, sfida jonë është arritja e objektivave të përcaktuar nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara. Bashkia duhet të përmbushë detyrimet e saj ligjore, dhe zbatojë vullnetin e saj për të ofruar dhe garantuar mbrojtje dhe zhvillim qytetarëve të Sarandës që i përkasin grupeve vulnerabël, në frymën e re të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe strategjisë Kombëtare për mbrojtjen Sociale.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Sigurisht në hartimin e Planit janë mbajtur parasysh edhe mundësitë financiare dhe burimet e të ardhurave që mund të ofrojë njësia vendore, për ta bërë planin të realizueshëm dhe efikas.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

A është objekt i konsultimit publik?

Është objekt i konsultimit publik. Seanca përkatëse u zhvillua në sallën e mbledhjeve, në bashkinë Sarandë, sipas dates dhe kalendarit të njoftimit publik.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 27.08.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.100 datë 29.08.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit social vendor 2026-2028 të Bashkisë Sarandë".

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

   Miratimin e projektaktit

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.102 datë 29.08.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-20230 të Bashkisë Sarandë".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji nr. 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", perfshi Rregulloren e Funksionimit te Keshillit bashkiak Sarande.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Barazia gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor dhe moral, por një parakusht i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm. Një Sarandë që ofron mundësi të barabarta për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, është një qytet më i fortë, më konkurrues dhe më solidar. Përmes këtij plani, ne synojmë të integrojmë perspektivën gjinore në çdo fushë të jetës vendore: nga vendimmarrja dhe ekonomia, tek arsimi, shëndeti, kultura, mjedisi dhe turizmi.

Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, ku janë bashkuar përpjekjet e administratës vendore, Këshillit Bashkiak, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit, të rinjve, grave dhe burrave të Sarandës. Kontributi i tyre ka qenë i pazëvendësueshëm për të hartuar një plan realist, të bazuar në nevojat e komunitetit dhe të mbështetur mbi praktika të mira.

Barazia gjinore nuk është një çështje vetëm e grave, por një vlerë që prek çdo familje dhe e ardhmja e çdo qyteti dhe me anë të këtij projekt vendimi të krijojmë politika, shërbime dhe mundësi që reflektojnë këtë bindje.

Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2025–2030 i Bashkisë Sarandë përcakton drejtimet kryesore të punës për arritjen e vizionit dhe objektivave strategjikë, duke u mbështetur në një analizë të thelluar të situatës aktuale, trendeve demografike e socio-ekonomike, si dhe në vlerësimin e sfidave dhe mundësive zhvillimore të territorit. Këto fusha ndërhyrjeje janë të harmonizuara me prioritetet kombëtare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, si dhe me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Çdo fushë ndërhyrjeje synon të adresojë dimensione të ndryshme të pabarazisë gjinore – nga pjesëmarrja në vendimmarrje dhe fuqizimi ekonomik, te mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore dhe garantimi i aksesit të barabartë në shërbime. Nëpërmjet këtyre fushave, plani synon jo vetëm të eliminojë pengesat ekzistuese, por edhe të krijojë mekanizma të qëndrueshëm që promovojnë përfshirjen, fuqizimin dhe zhvillimin e barabartë të të gjitha grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në territorin e Bashkisë Sarandë.

1. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje

Kjo fushë ndërhyrjeje synon të forcojë demokracinë vendore duke garantuar përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, nga Këshilli Bashkiak deri te strukturat e këshillimit komunitar. Veprimet do të përfshijnë zbatimin e kuotave gjinore, krijimin e programeve për zhvillimin e lidershipit të grave dhe vajzave, dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të tyre në proceset e buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultimet publike.

2. *Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave*

Duke u bazuar në potencialet ekonomike të Bashkisë Sarandë, kjo fushë fokusohet në mbështetjen e grave dhe vajzave për të hyrë, qëndruar dhe avancuar në tregun e punës. Ajo përfshin mbështetje financiare dhe teknike për sipërmarrjet femërore, zhvillimin e aftësive profesionale përmes trajnimeve dhe mentorimit, si dhe lehtësimin e aksesit në kredi me kushte të favorshme dhe programe subvencioni. Sektorë prioritarë do të jenë turizmi, agrobiznesi dhe artizanati lokal, duke synuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

3. Parandalimi dhe reagimi efektiv ndaj dhunës me bazë gjinore

Kjo fushë ka në qendër forcimin e mekanizmave të koordinuar për menaxhimin e rasteve të dhunës, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR), si dhe sigurimin e shërbimeve të specializuara për viktimat. Veprimet do të përfshijnë strehim emergjent, ndihmë psikologjike dhe juridike, si dhe fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi për parandalimin e dhunës dhe promovimin e të drejtave të grave. Fokus i veçantë do t'i kushtohet mbrojtjes së grave dhe vajzave në zonat rurale dhe të izoluara.

4. Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore
Objektivi i kësaj fushe është të sigurojë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, të përshtatura me nevojat e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në të gjithë territorin e bashkisë. Do të punohet për zgjerimin e mbulimit gjeografik të shërbimeve sociale, ofrimin e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit për të lehtësuar barrën e kujdesit mbi gratë, si dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore cilësore, përfshirë shëndetin riprodhues.

5. Integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe buxhetimin vendor

Kjo fushë synon të institucionalizojë integrimin e barazisë gjinore në të gjitha proceset e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave vendore. Veprimet përfshijnë futjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, trajnimin e stafit të administratës mbi analizën dhe raportimin gjinor, si dhe krijimin e mekanizmave për monitorimin e treguesve gjinorë në nivel bashkiak.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:

Banoret e bashkise Sarande.

A është objekt i konsultimit publik?

Është objekt i konsultimit publik. Seanca përkatëse u zhvillua në sallën e mbledhjeve, në bashkinë Sarandë, sipas dates dhe kalendarit të njoftimit publik.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 27.08.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.102 datë 29.08.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-20230 të Bashkisë Sarandë".
Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   Miratimin e projektaktit

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.97 datë 29.08.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Korrik 2025".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr 6 date 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", perfshi Rregulloren e Funksionimit te Keshillit bashkiak Sarande.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

1. Bashkia Sarande kerkon miratimin e përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe trajtimin ne total 23 familje me një fond prej 71.947 (*shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë*) dhe konkretisht :
   Për Bashkinë Sarandë 23 familje me një fond prej 71.947 (*shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë*) lekë sipas listës nr.1 bashkëlidhur.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Lista nr.1

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Mariana Petref Ahmeti	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme, pensioniste
2	Esmine Sulo Jakupi	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme, pensioniste
3	Elvira Gogo Nikaj	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme, pensioniste
4	Hanko Koçi Kordha	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme, pensioniste
5	Nimete Ali Hasani	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te

		pamjaftueshme,pensioniste
6	Novruze Myrteza Terrolli	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme,pensioniste
7	Kadri Beqir Xhafa	Familje pensionistesh me të ardhura te pamjaftueshme dhe me probleme shëndetësore
8	Marija Idriz Muço	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
9	Aferdita Hajdar Allushi	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
10	Kostando Thodhori Llambro	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
11	Vidë Njac Vata	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,prag pensioni
12	Tanë Flamur Sheme	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
13	Muhazeze Galip Avdi	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
14	Violeta Sadik Kafeja	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
15	Stavrulla Perikli Gaja	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
16	Marjana Pando Sotiri	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
17	Elida Hajredin Kanani	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
18	Mjaftoni Pëllumb Ibraj	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
19	Jorgjia Nestor Kozllorof	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,prag pensioni
20	Evanthia Gjik Petko	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
21	Sulltana Halim Sulka	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
22	Vasiliqi Resmi Mërtiri	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste
23	Bejushe Muhamet Matai	Kryefamiljare grua, skualifikuar per pike te pamjaftueshme ,pensioniste

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.
Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 27.08.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.97 datë 29.08.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Korrik 2025".

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

   Miratimin e projektaktit

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)
Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.98 datë 29.08.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga te ardhurat e bashkisë për muajin Korrik 2025".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 6 date 30.01.2025"Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.73 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2025", si edhe Rregullores se Funksionimit te keshillit bashkiak Sarande.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbeshtetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin Korrik 2025 në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 35 familje me një fond 161.587 *(njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë)* lekë dhe konkretisht:

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	28	121.016
2	Njesia Administrative Ksamil	7	40.571

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Korrik 2025 janë sipas listës bashkëlidhur.

Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike familjet si më poshtë:

Qendra e Bashkisë Sarandë

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e daljes nga skema
1	Meho Hamza Çukari	Ka ndërruar jetë
2.	Hazis Maliq Dervishi	Nuk është paraqitur
3.	Miranda Shefqet Kaloti	Përmirësim i gjendjes ekonomike, ka filluar punë
4.	Sulltanë Halim Sulka	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE
5.	Evanthia Gjik Petko	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE
6.	Jorgjia Nestor Kozllorof	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE
7.	Mariana Petref Ahmeti	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE
8.	Esmine Sulo Jakupi	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE
9.	Vasiliqi Resmi Mërtiri	Përfiton nga skema 6% e Bllokskemës së NE

Njësia Administrative Ksamil

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e daljes nga skema
1	Bujar Rrahman Çipi	U gjetën ndryshime, përmirësim i gjendjes ekonomike

Rifuten ne skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë Sarandë 3 familje:

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Felatun Dragush Mehmeti	Familje njëprindërore me probleme te shumta social-ekonomike
2	Bledar Gëzim Sulejmani	Familje njëprindërore me probleme te shumta social-ekonomike
3	Marijana Koço Bubuçi	Kryefamiljare grua, pensioniste, me te ardhura te pamjaftueshme
4	Faike Hysen Delilaj	Kryefamiljare grua, pensioniste, me te ardhura te pamjaftueshme
5	Luljeta Ilmas Jaho	Kryefamiljare grua, pensioniste, me te ardhura te pamjaftueshme

2.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi: (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike, në bashkinë Sarandë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

Impakti social / grupet që preken:

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 27.08.2025, shqyrtoi projektvendimin nr 98 datë 29.08.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për periudhën korrik 2025, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

   Miratimin e projektaktit

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Enea Vasili **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I ARSIMIT, KULTURËS, SPORTEVE
RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr.101 datë 29.08.2025, relacionit e dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit vendor të arsimit parauniversitar, të Bashkisë Sarandë".

Analiza ligjore:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji nr. 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi",Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social", Ligji nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", perfshi Rregulloren e Funksionimit te Keshillit bashkiak Sarande.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Qëllimi i këtij plani është të vijoje të shërbeje si një platformë strategjike dhe gjithëpërfshirëse që synon një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Sarabdë. Plani që propozojmë, do të vijojë të luajë një rol të rëndësishëm për Bashkinë Sarandë , drejt rritjes së cilësisë së shërbimit të arsimit dhe konsolidimit të standardeve të tij. Qëllimi i këtij plani është të përmirësojë cilësinë e arsimit në Bashkinë Sarandë duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së institucioneve arsimore, të sigurojmë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Sarandë të ketë akses në arsim parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të drejtë, të zhvilluar në mjedise të sigurta e të përshtatshme, me mësues të përgatitur dhe mbështetje të vazhdueshme, duke e trajtuar arsimin si një shtyllë themelore për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit, forcimin e barazisë dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe institucionale Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Plani i arsimit parauniversitar në Bashkinë Sarandë , përqendrohet në proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve/ nxënësve në institucionet arsimore dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë kryesisht rikonstruksione e IA-ve me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në çerdhe, kopshte dhe shkolla dhe më pas një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe minimizimit të braktisjes shkollore dhe orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional. Gjithashtu në fokus është edhe vemendja shtuar që do tu kushtohet fëmijëve/nxënësve qe vijne nga familjet ne nevoje duke u krijuar mbeshtetje si dhe mundesi per perfshirje ne programe edukative dhe sociale plotesuese.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar, në bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar dhe keshilli bashkiak.

Impakti social / grupet që preken:

Komuniteti i femijeve dhe prinderve te bashkise Sarande dhe jo vetem.

A është objekt i konsultimit publik?

Është objekt i konsultimit publik. Seanca përkatëse u zhvillua në sallën e mbledhjeve, në bashkinë Sarandë, sipas dates dhe kalendarit të njoftimit publik.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 28.08.2025, shqyrtoi projektvendimin nr.101datë 29.08.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për miratimin e planit vendor të arsimit parauniversitar, të Bashkisë Sarandë".
Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
   Miratimin e projektaktit

Ermir Hoxa — **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Katerina Beqo — **Anëtar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Bejdo Çela — **Anëtar i Komisionit**